



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFËRMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 1137/Prot
1

Tiranë, më 12/11 / 2015

Lënda: *Jepet mendim për projektligj.*

Drejtuar: **Zotit Fatmir XHAFAJ, KRYETAR**
Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

KUVENDI I SHQIPËRISË

Tiranë

I nderuar zoti Kryetar,

Projektligji "Per një shtesë në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, lidhet me një nga të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, lirinë e shprehjes.

E drejta për lirinë e të shprehurit lidhet ngushtë me lirinë për të kërkuar dhe pranuar informacion. Kjo e drejtë është përbërësi kryesor i qeverisjes demokratike për shkak se promovimi i proceseve pjesëmarrëse të vendimmarrjes është i paarritshëm pa informimin mbi dokumentet zyrtare.

Instrumentat ndërkombetare për të drejtat e njeriut, pranojnë se liria e të shprehurit mund të kufizohet me ligj në mënyra të caktuara, të përcaktuara qartë dhe në rrethana të veçanta. Kufizimet gjatë ushtrimit të lirisë së të shprehurit nuk mund të vënë në rrezik të drejtën.

Ato duhet të përcaktohen me ligj, i cili duhet të jetë i qartë dhe i arritshëm për të gjithë duke garantuar parimin e sigurisë ligjore, parashikimit dhe transparencës; ato duhet të mbrojnë të drejtat ose reputacionin e të tjerëve, të mbrojnë sigurinë kombëtare, rendin publik ose shëndetin apo moralin publik duke garantuar parimin e legjitimitetit; ato duhet të vërtetohen si të domosdoshme dhe si mjetet me kufizim më të vogël të nevojshëm dhe në përputhje me qëllimin e supozuar, në garantim të parimit të domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit.

Nga ana tjetër, mbrojtja e të dhënave personale gjen vënd në jurisprudencën e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, ku ndër të tjera arsyetohet se *politikanët duhet të presin një shkallë më të ulët të mbrojtjes së privatësisë së tyre. Kritikat ndaj tyre pa dyshim janë më të forta ashtu sikundër janë më pak të mbrojtur nga privatësia dhe se do të jetë fatale për lirinë e shprehjes në sferën e politikës nëse figura publike mund të censurojë shtypin dhe debatin publik në emër të të drejtave të tyre të personalitetit.*

Ligji nr. 119/2014, “Për të Drejtën e Informimit” dhe ligji nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, përcaktojnë fushat ku shtrihet veprimtaria e Institucionit të Komisionerit.

Për këtë arsye, sa më sipër mbetet një vlerësim me karakter të përgjithshëm, për aq sa liria e shprehjes lidhet me të drejtën për informim dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për vlerësimin dhe bashkëpunimin,

